



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## ***BULETINI DITOR I FSSHM-së***

### ***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE***

***02 Shkurt 2016***



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Në "Alo doktor" për një javë 1.313 thirrje

Në linjën telefonike 02/15 123 për këshilla mjekësore "Alo doktor" javën e kaluar (nga 25 janari deri më 31 janar) ka pasur 1.313 thirrje...



Nga 15 shtatori i vitit 2014 kur filloi me punë linja telefonike "Alo doktor" deri më tani ka pasur 74.488 thirrje. Linja është në dispozicion 24 orë në ditë në mënyrë që të mundësojë konsultim të menjëhershëm mjekësor në kohën e shfaqjes së simptomave të ndryshme të çrregullimit të shëndetit.

Njëzet e pesë mjekët janë në dispozicion për këshilla mjekësore. Telefonatat janë nga qytetarët nga të gjitha qytetet e Maqedonisë.

Thirrjet janë për një spektër të gjerë të simptomave të ndryshme, zakonisht janë për simptoma respiratore, tension i rritur i gjakut, simptoma të dhimbjes, temperaturë e lartë trupore, viroza dhe kollë nga ndryshimi motit.

Të gjithë personave që kanë kërkuar këshilla mjekësore në linjën telefonike "Alo doktor" u është dhënë ndihmë mjekësore me këshillë shëndetësore dhe terapi përkatëse simptomatike. ([mia.mk](http://mia.mk))



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Fakte për infeksionin virsual ZIKA

### Çfarë është infeksioni viral Zika?

Infeksioni viral Zika është një sëmundje të cilën e përcjellin mushkonjat e llojit Aedes, e që shkaktohet nga virusi Zika (ZIKV).

Ky virus për herë të parë është izoluar në vitin 1947 në Zika – një zonë pyjore në Ugandë. Që atëkohë e deri më vitin 2007 virusi qarkullon në Afrikë me disa epidemi të vogla sporadike në Azinë juglindore. Nga viti 2007, me këtë epidemi u përballën edhe disa ishuj të paqësorit. Në vitin 2015 epidemi ZIKV për herë të parë janë regjistruar edhe në Amerikën jugore.

Nga muaji shkurt i vitit 2014 deri në janar të vitit 2016 30 vende dhe territore kanë konfirmuar për qarkullim autokton të virusit Zika.

### Si përcillet infeksioni viral Zika?

Virusin Zika e përcjellin mushkonjat e llojit Aedes, që gjithashtu përcjellin ethet denga, çikungunja dhe ethet e verdha.

Këto mushkonja pickojnë gjatë ditës (sidomos në agim dhe gjatë orëve të vona të pasdites dhe në muzg).

Përveç përmes vektorëve (mushkonjat e llojit Aedes) përcjellja mund të bëhet nga nëna e infektuar tek foshnja, ndërsa janë raportuar edhe raste kur përcjellja është bërë gjatë aktit seksual, por rrugët e tjera të transmetimit janë lëndë e hulumtimeve të mëtejshme. Ekziston edhe rrezik potencial nga ZIKV gjatë transfuzionit të gjakut.

### Cilat janë simptomat?

Simptomat më të shpeshta të infeksionit viral Zika janë ethet e buta të shoqëruara me irrim të lëkurës, si dhe me konjunktivit, dhimbje të muskujve dhe nyjave dhe me debulesë të përgjithshme. Simptomat shfaqen pas 3 deri më 12 ditë nga pickimi nga mushkonja e infektuar.

Shumica e infeksioneve janë simptomatike, gjegjësisht simptoma zhvillon një nga katër persona të infektuar. Simptomat e sëmundjes zakonisht janë të buta dhe zgjasin 4-7 ditë, pa komplikime të rënda. Bëhet fjalë për një sëmundje me një shkallë të ulët të hospitalizimit dhe deri më tani nuk janë regjistruar raste të vdekjes.

Në epidemitë e fundit (Polinezi dhe Brazil) janë raportuar edhe çrregullime autoimune, neurologjike dhe zhvillimore-neurologjike, si sindroma Guillain-Barre dhe mikroencefalia tek fetuset dhe foshnjat e lindura nga



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



nëna të cilat mbase kanë qenë të ekspozuara ndaj virusit Zika në dy tremujorët e parë të shtatzënisë. Duhet siguruar prova të mëtutjeshme për ta vërtetuar lidhjen mes këtyre çrregullimeve neurologjike/zhvillimore dhe virusit Zika.

## Si diagnostikohet?

Sëmundja diagnostikohet me ndihmën e analizave molekulare dhe serologjike të mostrave të marra nga pacientët e dyshuar. Diagnostikimi i virusit Zika bëhet mbi bazë të zbulimit të materialeve gjenetike nga mostra klinike të marra nga pacientë me sëmundje akute (3-5 ditët e para). Analizat serologjike bëhen edhe në rrjedhën e mëvonshme të sëmundjes dhe shërimit, ndërsa rezultatet duhen interpretuar në pajtim me statusin vaksinal dhe ekspozimin paraprak ndaj infeksioneve të tjera flavivirale.

Kjo sëmundje duhet të merret në konsideratë sidomos për udhëtarët të cilët kanë qëndruar në ndonjë nga vendet ku është regjistruar kjo sëmundje. Mund të shfaqet edhe si ko-infeksion me sëmundje të tjera të cilat i përcjellin mushkonjat, si për shembull ethet denga, çikungunja dhe malaria.

## Trajtimi?

Nuk ekzistojnë barna specifike apo vaksinë për trajtimin apo mbrojtje nga infeksioni Zika. Prandaj, rekomandohen të merren masa preventive personale për evitimin e pickimit nga mushkonjat.

Trajtimi është simptomatik dhe kryesisht bazohet në zvogëlimin e dhimbjes, temperaturës si dhe aplikimit të antihistaminikëve për të qetësuar irritimin.

**MASAT MBROJTËSE PERSONALE DHE PARANDALIMI**

Edhe parandalimi bazohet në mbrojtjen nga pickimi i mushkonjës. Mushkonjat Aedes kanë një aktivitet ditor në mjedise të hapura dhe të mbyllura. Prandaj, masat për mbrojtje duhet aplikuar gjatë gjithë ditës, e sidomos gjatë kohës kur aktiviteti i mushkonjave është më i lartë (sidomos në agim dhe gjatë orëve të vona të pasdites dhe në muzg).

Gjatë qëndrimit në zona me rrezik duhet të merren këto masa preventive personale për të evituar pickimin nga mushkonjat:

- PËRDORNI repetentë, veshje me mëngë të gjatë dhe pantallona të gjata, sidomos gjatë periudhës së ditës kur mushkonjat janë më aktive. Përdorimi i repetentëve duhet bërë sipas udhëzimeve të shënuara në etiketën e produktit. Për foshnjat nën tre muaj nuk rekomandohet përdorimi i tyre.
- PËRDORNI rreth krevateve rrjeta kundër mushkonjave e të lyera me insekticide me veprim më afatgjatë (shumë të rëndësishme për sigurimin mbrojtjes nga mushkonjat).
- SHKATËRRONI vendet ku shumohen mushkonjat.
- Udhëtarët, sidomos fëmijët, gratë shtatzëna dhe personat me sëmundje të sistemit imunitar apo me sëmundje kronike duhet të KËSHILLOHEN me mjekun ose të kërkojnë rekomandime për përdorimin e masave mbrojtëse dhe preventive para se të nisen në udhëtim.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: info@fzo.org.mk



- Masa të ngjashme zbatohen edhe për pacientët simptomatik, për të parandaluar përcjellja e sëmundjes tek mushkonjat e painfektuara.

#### Edhe diçka:

- Mënjaroni rregullisht kontejnerët e hapur me ujë të ndenjtur nga shtëpitë apo mjedisi ku jetoni (saksi, tenxhere, goma të vjetra, pishina)
- Mbulojini kontejnerët për ujë, fuçitë, bunarët dhe rezervuarët për depozitim të ujit për pije dhe për nevoja të tjera në amvisëri.

#### Instituti i shëndetit publik i Republikës së Maqedonisë

#### Sektori për kontroll dhe parandalim të sëmundjeve infektive

## Ass.Dr. Shaban Memeti: Virusi Zika, OBSH shpall emergjencën shëndetësore ndërkombëtare



prekë 4 milionë

**Shkup, 1 shkurt** - Organizata Botërore e Shëndetit shpalli sot gjendjen e emergjencës shëndetësore ndërkombëtare të virusit Zika.

Kjo është hera e katërt që OBSH shpall gjendjen e jashtëzakonshme në historinë e saj.

Vjen pak ditë pasi kjo organizatë deklaroi se virusi Zika mund të njerëz deri në fund të vitit.

Virusi Zika është zbuluar në një majmun në Ugandë në vitin 1947, ndërsa rasti i parë në njeri është regjistruar në Nigeri në vitin 1954.

I lindur nga mushkonja, virusi ka qarkulluar në Afrikë dhe Azi për dekada të tëra dhe së voni në rajonin e Paqësorit, por asnjëherë nuk ka shkaktuar shumë shqetësim.

Virusi po përhapet vrullshëm, pasi është zbuluar në Brazil vitin e kaluar, ka shtuar Chan. Sipas saj, "niveli i alarmit është jashtëzakonisht i lartë".

Infeksione me virusin Zika tashmë po ndodhin në rreth 20 shtete dhe territore në Karaibe dhe Amerikën Veriore e Jugore.

Për këtë virus nuk ka ende trajtim të veçantë apo vaksinë.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Shkencëtarët kanë luftuar me vite për të zhvilluar një vaksinë për ethe tropikale, të cilat lidhen me virusin Zika; doza e parë e tillë, e bërë nga kompania farmaceutike Sanofi Pasteur, është licencuar vitin e kaluar në Brazil.

Për njerëzit në zonat e prekura, Organizata Botërore e Shëndetësisë ka rekomanduar pastrimin e ujit të ndenjtur, ku grumbullohen mushkonja.

Ajo po ashtu u ka bërë thirrje njerëzve që të mbrohen nga kafshimi i mushkonjave, duke veshur rroba që mbulojnë sa më shumë trupin e tyre dhe duke mbajtur mbyllur dyert dhe dritaret.



## Ajri më i ndotur në Lisiçe dhe Tetovë



Në lagjen Lisiçe të Shkupit dhe në Tetovë sot në mëngjes është ajri më i ndotur. Janë matur përqendrime të PM 10 grimcave prej 185 mikrogramëve në Lisiçe dhe 125 në Tetovë. Stacionet matëse në Karposh kanë regjistruar 109 mikrogramë, në Rektorat 106, në Gazi Babë 104 dhe në Veles 70.

Gjatë natës janë regjistruar përqëndërime më të larta se në mëngjes.

Në Lisiçe janë matur 591 mikrogram, 336 në Tetovë, 314 në Gazi Babë, 269 në Rektorat, në Qendër 244, në Karposh 238, në Kërçovë 171, në Kavadar 166 dhe Miladinovci 159.